




Këshilla kryesore për të mbrojtur veten tuaj në internet

Aksesi në internet ju ndihmon të qëndroni të lidhur me familjen dhe miqtë, ju mban të përditësuar me lajmet dhe shumë më tepër. Sidoqoftë, është e rëndësishme të kuptoni rreziqet e mundshme që mund të hasni. Ndiqni më poshtë disa këshilla të vlefshme.

1. Jini të vetëdijshëm se çfarë informacioni po ndani




Kur jeni duke hapur një llogari, vendosni vetëm informacione që janë të nevojshme dhe të arsyeshme.

Përdorni cilësimet e privatësisë dhe sigurisë dhe çaktivizoni çdo veçori që nuk ju nevojitet.


2. Mendoni para se të postoni

Të postuarit kur jeni emocional nuk është gjithmonë një ide e mirë, ajo që postoni në internet qëndron atje përgjithmonë. Edhe nëse e fshini më pas, dikush mund ta ketë ruajtur.

Prisni derisa të jeni më të qetë dhe më pas mendoni përsëri.



3. Merrni parasysh pasojat




3. Merrni parasysh pasojat

Mashtruesit mund të përdorin informacionin që ju jepni lirisht në mediat sociale - për t'ju spiunuar, për t'ju mashtruar për para ose për të vjedhur identitetin tuaj.


4. Mendoni para se të klikoni

Përpara se të merrni pjesë në një lojë argëtuese që po bën xhiron e rrjeteve sociale, merrni parasysh se çfarë po ju kërkojnë - emrin e kafshës suaj të parë apo emrin e vajzërisë së nënës suaj?

Këto janë të njëjtat pyetje që përdoren për sigurinë edhe nga platforma të tjera kështu që përgjigjja e tyre mund të jetë dhënie e informacionit të rëndësishëm për hakerat.



5. Sigurohuni që e dini se me kë po komunikoni



Kini parasysh se mashtruesit përdorin rrjetet sociale, faqet e internetit dhe dërgojnë mesazhe në telefonin tuaj për të vjedhur informacionin tuaj ose identitetin tuaj.

Ju mund të mbron veten duke mos dhënë asnjë informacion personal, vetëm nëse mund të verifikoni me një mjet tjetër komunikimi se me kë po i ndani informacionet tuaja.

6. Qëndroni të përditësuar me lajmet e sigurisë kibernetike

Duke ndjekur lajmet më të fundit që ju njoftojnë për sulmet mashtruese si: mashtrimet e phishing, programet keqdashëse dhe faqet e internetit të rreme mund t'ju ndihmojnë të lundroni më të sigurt në internet.

